



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 16 Akti**

**Nr. 57 Vendimi**

**Tiranë, më 01.08.2018**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                       |                 |
|-----------------------|-----------------|
| <b>Lulzim Hamitaj</b> | <b>Kryesues</b> |
| <b>Firdes Shuli</b>   | <b>Anëtare</b>  |
| <b>Roland Ilia</b>    | <b>Relator</b>  |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 30.07.2018, ora 16:00 dhe datë 01.08.2018, ora 09:15, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKT I RIVLERESIMIT:** **Znj. Brunilda Kadi**, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE :** **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar, me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligj nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioner Roland Ilian, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, duke qenë se është kandidat për Këshillin e Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (referuar më poshtë “Komisioni”).

3. Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, në periudhën nëntor 2003 - nëntor 2011, ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Nga nëntor 2011 e aktualisht ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

4. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni, ka hedhur shortin, më datë 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, do t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilija dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioner Roland Ilija. Me vendimin nr. 29, datë 23.05.2018, Komisioni ka vendosur që komisionerja Alma Faskaj të zëvendësohet nga komisioneri Lulzim Hamitaj.

5. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\*, datë 09.11.2017.

6. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me

shkresën nr. \*\*\*, datë 26.10.2017 dhe deklasifikuar me vendim të KDZH-së, nr. \*\*\* prot., datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

7. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\*, datë 27.12.2017.

8. Menjëherë pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 1, administroi:

- Raportin e vlerësimit të pasurisë sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (më poshtë referuar si “ILDKPKI”),
- Raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016 nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (më poshtë referuar si “DSIK”),
- Raportin e vlerësimit profesional sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (më poshtë referuar si “KLD”).

9. Me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Brunilda Kadi në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Lulzim Hamitaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

10. Me vendimin nr. 2, datë 11.07.2018, trupi gjykues, vendosi:

- Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me vlerësimin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, dhe t’i kalojë asaj barrën e provës mbi rezultatet e hetimit, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative;
- Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin 7-ditor brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

11. Më datë 19.07.2018, subjekti i rivlerësimit njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit parashtrësë me pretendimet e tij dhe dokumente shkresore, të cilat u administruan nga ana e trupit gjykues.

10. Me vendimin nr. 3, datë 26.07.2018, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 30.07.2018, ora 16:00, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati i 2-të, Tiranë.

11. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, duke u bazuar në të tria kriteret.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 26.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 30.07.2018, ora 16:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Thuma

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ajo parashtroi shpjegimet e saj në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit. Gjithashtu, znj. Brunilda Kadi iu përgjigj pyetjeve që iu drejtuan në seancë, duke specifikuar dhe qartësuar këndvështrimin e saj.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Znj. Brunilda Kadi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë

vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>[1]</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Në përputhje me nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Znj. Brunilda Kadi është bërë subjekt deklarues që në vitin 2003. Më datë 24.01.2017, referuar ligjit numër nr. 84/2016, ka dorëzuar Deklaratën e Pasurisë së Vlerësimit Kalimtar-Vetting, pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

### **2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e subjektit, është kryer proces i plotë hetimor administrativ nga Komisioni sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: deklaratimet e subjektit

---

<sup>[1]</sup>“41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

pranë ILDKPKI-së; provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit; çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; komunikimet me subjektin; si dhe sugjerime të vëzhguesit ndërkombëtar, për rrethana konkrete në procesin vlerësimit të pasurisë.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, në verifikimin e burimeve të krijimit të te ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë, në evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive, deklarimeve të rremë apo konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

Procesi i rivlerësimit të pasurisë nga ana e Komisionit është bazuar në sa më poshtë:

### **Lidhur me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën “Vetting” nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur.**

- 1. Apartament banimi**, me sip. 124.81m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, i blerë bashkë me bashkëshortin, më datë 09.02.2008, me kontratë porosie dhe i regjistruar vetëm karabina. Vlera totale 63.661 euro. Subjekti zotëron 50 % dhe 50 % bashkëshorti.

**Burim i krijimi:** Kredi pranë “Alpha Bank”, Tiranë, në vlerën 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) euro.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni:**

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë konfirmon se nga verifikimi i bërë informacionit dixhital dhe manual, si dhe dokumentacioni që disponon ZVRPP-ja Tiranë, rezulton se pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, lloji i pasurisë, apartament me sip. 124.81 m<sup>2</sup>, Tiranë (pasuri aktive), është regjistruar në emër të znj. Brunilda Kadi dhe z. G.K<sup>1</sup>.

### **Lidhur me deklarin ndërvite**

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë, apartament banimi 3+1, ndodhur në \*\*\*, komuna Dajt, Tiranë. Apartamenti është blerë me bashkëshortin, më datë 09.02.2008, sipas kontratës noteriale të porosisë së kësaj date. Apartamenti është i regjistruar karabina dhe nuk ka përfunduar regjistrimi përfundimtar. Vlera e apartamentit 63.661 (gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) euro. Pagesa është bërë deri në shumën 58.661euro, dhe 5.000 euro janë të pashlyera, për t’u paguar në momentin e regjistrimit përfundimtar. Pagesa për këtë apartament është bërë e mundur

---

<sup>1</sup> Shih shkresën e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, nr. \*\*\*, datë 04.06.2018.

nëpërmjet kredisë së marrë në “Alpha Bank”, Tiranë, në vlerën totale të kredisë 85.000 euro, kredi e marrë së bashku me bashkëshortin, me afat shlyerjeje 20 vjet.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë apartament banimi 3+1 në \*\*\*, komuna Dajt, Tiranë, i blerë bashkë me bashkëshortin G.K., më datë 09.02.2008, me kontratë porosie dhe i regjistruar vetëm karabina. Vlera e apartamentit 63.600 (gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) euro. Në këtë kohë është bërë pagesa prej 58.661 eurosh, sikundër është shpjeguar në deklarinimin e këtij viti, ndërsa më datë 19.01.2011, është bërë kontrata e shitblerjes dhe regjistruar në Zyrën Rajonale të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë duke u bërë në këtë moment dhe pagesa e mbetur prej 5000 eurosh kundrejt shitësit.

Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë, apartament banimi 124.81 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë, i blerë me bashkëshortin, më datë 09.02.2008, me kontratë porosie dhe i regjistruar vetëm karabina. Vlera e apartamentit 63.600 (gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) euro. Në këtë kohë është bërë pagesa prej 58.661 eurosh dhe më datë 19.01.2011 është bërë kontrata e shitblerjes dhe regjistruar në ZRPP-në Tiranë, duke u bërë në këtë moment dhe pagesa e mbetur prej 5.000 eurosh kundrejt shitësit. Paratë për blerjen e këtij apartamenti janë marrë kredi në shumën 85.000 euro pranë “Alpha Bank”, Tiranë.

### **Lidhur me origjinën e krijimit të kësaj pasurie**

Apartamenti është porositur më datë 08.02.2008, me kontratë porosie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., me vlerë 70.735 euro. Më datë 19.01.2011 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. Në këtë kontratë vlera e apartamentit është përcaktuar në shumën 63.600 euro, vlerë e cila nuk përputhet me vlerën e përcaktuar në kontratën e porosisë.

Në lidhje me këtë mospërputhje të çmimit të shitjes, është pyetur subjekti i rivlerësimit, e cila më datë 30.04.2018, sqaron se: *“Çmimi i deklaruar në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2008 dhe 2011 si dhe në atë të rivlerësimit, është ai i përcaktuar në kontratën e shitjes që është në shumën 63 600 euro. Në momentin e nënshkrimit të kontratës është rënë dakord mes palëve që çmimi i shitjes së apartamentit do të deklarohet afërsisht dhe se shuma e saktë do të përcaktohej në momentin kur do të bëhej kontrata e shitjes.... Te kjo kontratë (kontrata e porosisë) është pasqyruar fakti që i janë dhënë shitësit 7.000 euro.... Kjo shumë është kthyer pas disa ditësh nga pala shitëse ...”.*

Gjate hetimit administrativ u vërtetua se këto sqarime të subjektit të rivlerësimit përputhen me provat e administruar nga Komisioni, nga ku rezulton se:

- Në kontratën e porosisë, datë 09.02.2008, pasqyrohet se subjekti i rivlerësimit, ditën e redaktimit të kësaj kontrate, ka likuiduar 10 % të vlerës së apartamentit në shumën 7.000 euro, ndërsa pjesa tjetër do të likuidohet me marrjen e kredisë nga banka.

- Pasi i kaloi e drejta e barrës së provës lidhur me shumën prej 7000 eurosh, subjekti paraqiti pretendime dhe prova shkresore<sup>2</sup>, nga të cilat rezulton se **kjo shumë nuk është pjesë e blerjes së apartamentit**. Konkretisht, me deklaratën noteriale, më datë 16.07.2018, z. A.I. deklaroi se në fillim të muajit shkurt 2008 i ka dhënë subjektit të rivlerësimit shumën prej 7.000 eurosh, pa dokument shkresor (*dokumentimi i dhënies dhe kthimit të shumave në këtë vlerë, nuk është detyrim ligjor*), me qëllim që të kryente një parapagesë te shoqëria ndërtuese. Kjo shumë i është kthyer atij (deklaruesit A.I.) nga ana e subjektit pas disa ditësh.

- Në çdo deklaram periodik, çmimi i shitjes së kësaj pasurie është deklaruar në shumën prej 63.600 eurosh, shumë e cila përkon me çmimin e shitjes në kontratën përfundimtare të shitjes së kësaj pasurie, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.01.2011.

Në përfundim, lidhur me shumën prej 7.000 eurosh, Komisioni krijoi bindjen se shuma prej 7.000 eurosh, nuk është pjesë e çmimit të blerjes së pasurisë dhe se, në mungesë të provës së kundërt, çmimi real i blerjes së pasurisë në fjalë duhet konsideruar ai i pasqyruar në kontratën e shitjes, pra prej 63.600 eurosh. Ndërsa, shuma prej 70.000 eurosh, është çmimi fillestar i parashikuar në kontratën e porosisë, pas së cilës palët kanë rënë dakord për ndryshimin e çmimit të blerjes, por pa dokument shkresor. Kjo dakordësi midis palëve, vërtetohet me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.01.2011, ku çmimi i shitjes është 63.600 euro. Duke qenë se ka rezultuar e provuar pagesa e shumës prej 58.661 eurosh, nëpërmjet kredisë bankare, dhe 5.000 euro kanë ngelur ende pa u paguar, Komisioni vlerëson se shuma prej 7.000 eurosh, nuk duhet t'i nënshtrohet analizës financiare.

### **Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë**

Si burimi për krijimin e apartamentit është deklaruar huaja në shumën 85.000 euro pranë "Alpha Bank", marrë më datën 04.03.2008, me kontratë huaje nr. \*\*\*, datë 04.03.2008.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

- Në kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 04.03.2008, në pikën 2 të saj shkruhet se projekti i blerjes së apartamentit është në shumën 131.234 euro, nga e cila shuma prej 46.234 eurosh paguhet nga kredimarrësi dhe banka do të financojë shumën 85.000 euro. Për të saktësuar këtë konstatim i është kërkuar informacion "Alpha Bank".

- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.03.2018, "Alpha Bank", dërgon shtesën e kontratës për kufi kredie shumë qëllimor nr. \*\*\*, datë 12.10.2004, sipas së cilës konfirmohet që projekti i blerjes së apartamentit ka një kosto të përgjithshme në shumën 131.234 euro. Kontributi i kredimarrësit në financimin e projektit është në shumën 46.234 euro ndërsa pjesa tjetër e kostos së përgjithshme të projektit do të financohet nga banka.

- Duke u nisur nga fakti se shuma prej 46.234 eurosh (si kontribut i kredimarrësit në investim), nuk është përmendur nga ana e subjektit në asnjë nga deklaramet e saj, dhe ndërkohë që kjo shumë figuron në një kontratë të nënshkruar prej saj (kontrata e huas), i janë kërkuar sqarime

<sup>2</sup> Shih përgjigjet me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.07.2018, në dosjen e Komisionit.



subjektit<sup>3</sup>, lidhur me këtë shumë dhe burimet e krijimit të saj. Në përgjigjen e saj, subjekti shpjegon se: “... nga ana e saj dhe e bashkëshortit është kërkuar marrja e një kredie në shumën 85.000 euro..... nuk ka një projekt për të cilin flet pika 2 e kontratës dhe nuk ka një investim nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj në shumën 46.234 euro.. ..sipas shpjegimit që ju dha nga punonjësja e bankës këto dokumente duhet të jenë kërkuar prej tyre për të plotësuar dokumentacionin që kërkohej për të miratuar dhënien e kredisë në shumën 85.000 euro”. Gjate hetimit administrativ Komisioni administroi disa dokumente që subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion gjatë procesit të rivlerësimit .<sup>4</sup>

Gjate hetimit administrativ, dhe pas analizës financiare, pasi u verifikuan të gjitha dokumentet bankare dhe ato të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, **nuk rezultoi e vërtetuar që shuma prej 46.234 eurosh të jetë paguar nga subjekti apo bashkëshorti i saj**, sipas parashikimit në kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 04.03.2000. Si rrjedhim, kjo shumë nuk duhet t'i nënshtrohet analizës financiare.

Pra, kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit është në shumën 85.000 euro (131.234 - 46.234 = 85.000 euro), vërtetuar kjo me dokumentet e vëna në dispozicion nga subjekti dhe me shkresën nr. \*\*\*, datë 24.05.2018, të “Alpha Bank”, dhe është përdorur prej saj si vijon :

- ✓ Shuma e disbursuar prej 85.000 eurosh;
- ✓ Shpenzimet e marrjes së kredisë në shumën 483 euro;
- ✓ Shuma prej 58.661 eurosh, i është pasuar shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k;
- ✓ Pagimi i shumës prej 11.109,31 eurosh, është paguar për shlyerjen e kredisë së mëparshme.

Gjate hetimit administrativ është konstatuar se me shkresën si më sipër nga “Alpha Bank”, konfirmohet pagesa e shumës prej 58.661 eurosh në favor të shoqërisë ndërtuese, më datë 31.03.2008. Po kështu, te zëri *referenca e shënime për klientin*, është përshkrimi “ ..*kaluar nga z. G.K. te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., likuidim për blerje 2 apartamentesh*”. Ndërkohë, nga studimi i dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, rezultojnë një situacion punimesh dhe një preventiv për një apartament banimi 3+1, në vlerën 4.928.628 lekë, si dhe një situacion punimesh dhe një preventiv për një apartament banimi 1+1, në vlerën 2.573.268 lekë.

Nisur nga sa më sipër, për të qartësuar çdo dyshim lidhur me ekzistencën e dy apartamenteve në emër të subjektit, janë kryer disa veprime hetimore nga ana e Komisionit, si vijon:

a. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dhe deklarata noteriale<sup>5</sup>, të datës 15.07.2018, të nënshkruar nga z. A.M., në cilësinë e përfaqësuesit me prokurë të posaçme të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. sot, ndryshuar emri në “\*\*\*\*” sh.p.k., me anë të së cilës, konfirmohet fakti i shitjes të vetëm një banese, ndodhur në \*\*\*, shtetasve G. dhe Brunilda Kadi.

<sup>3</sup> Shih pyetësoarin dhe përgjigjet e datës 30.04.2018 në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup> Shih pyetësoarin e datës 30.04.2018, dhe dokumentet bashkëlidhur.

<sup>5</sup> Shih ne dosje deklarata noteriale, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol.

b. ZVRRPP-ja Tiranë konfirmon se pasuria nr. \*\*\*, vol, \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, lloji i pasurisë, apartament me sip. 124.81 m<sup>2</sup>, Tiranë (*pasuri aktive*), është regjistruar në emër të shtetasve Brunilda Kadi dhe G.K.

Në përfundim Komisioni konstaton përputhjen e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe krijoi bindjen se ajo ka në pronësi vetëm një apartament, të ndodhur në \*\*\*, komuna Dajt, Tiranë, që është pasuria objekt shqyrtimi.

Lidhur me nënshkrimin e një kontrate (*pika 2*), nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, Komisioni nuk vlerëson që ky veprim të këtë sjellë pasoja lidhur me pasurinë e subjektit të rivlerësimit pasi, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për shlyerjen e kredisë në vlerën prej 85.000 eurosh.

Duket që nënshkrimi i kontratës me kushtet e saj (*përfshirë dhe pikën 2*), të parashikuar nga banka kredidhënëse, është bërë pasi subjekti dhe bashkëshorti i saj janë dakordësuar me bankën, e cila nga ana e vet ka pasur si praktikë përfshirjen e objekteve me vlerë më të madhe se kredia që do të jepte për palën kredimarrëse.

- 2. Makinë, tip “Mercedes-Benz”, 250**, me vit prodhimi 1997, zotërim 50 % me bashkëshortin. Blerë më datë 21.11.2007 (*700.000 lekë plus, 320.000 mijë lekë për taksat doganore plus 50.000 lekë pagesë e taksës së regjistrimit, targa dhe shpenzime të tjera për lejen e qarkullimit*). Burim krijimi për këtë pasuri janë kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit nga të ardhurat.

Trupi gjykues, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë makinën tip “Mercedes-Benz”, 250. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka dyshime mbi këtë automjet. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga organet shtetërore<sup>6</sup>.

- 3. Makinë, tipi “Toyota Corola”, viti 1999**, e blerë më datë 15.06.2015, e cila ndodhet dhe është e regjistruar në Florida, SHBA. Vlera e makinës 1.200 (njëmijë e dyqind) USD, nga të cilat 500 USD është blerë, 125.25 USD shpenzime administrative dhe 575 USD për riparim. Të ardhurat për blerjen e kësaj makine kanë qenë pjesë e kursimeve të deklarueses dhe bashkëshortit. Zotërimi me 50 % me bashkëshortin.

Trupi gjykues, mbështetur në analizën ekonomike të të ardhurave dhe shpenzimeve vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë makinën e tipit “Toyota Corola” Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka dyshime mbi këtë automjet.

---

<sup>6</sup> Shih në dosje shkresën e Drejtorisë së Regjistrimit të Mjeteve, Licencimit dhe Certifikimit nr. \*\*\*, datë 21.02.2018.

- 4. Llogari rrjedhëse në “Credins Bank”, në shumën 1.574.780,64** (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë, presje gjashtëdhjetë e katër) lekë, 100 % në emër të subjektit të rivlerësimit. Burimi i krijimit: Kursime nga paga si gjyqtare gjatë vitit 2016 dhe pagesat gjatë vitit 2016 si anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, eksperte e nivelit të lartë në reformën në drejtësi -dhe si lehtësuese në trajnim nga Shkolla e Magjistraturës.

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e saj. Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

- 5. Llogari rrjedhëse në “Alpha Bank” me vlerë 29 USD**, në emër të deklaruesit, znj. Brunilda Kadi, si kursim nga pagesa e dietës së vizitës studimore në Oslo, Norvegji, viti 2016, nga UNDP, 22.19 USD. Zotërimi me 100% në emër të subjektit të rivlerësimit.

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e saj. Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

- 6. Llogari rrjedhëse në euro, te “Alpha Bank”,** në emër të deklarueses, znj. Brunilda Kadi dhe bashkëshortit, të krijuara nga kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, 1.690,88 (një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë presje tetëdhjetë e tetë) euro. Zotërimi 50 % me bashkëshortin.

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e saj. Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

- 7. Llogari rrjedhëse në USD, te “Intesa Sanpaolo Bank”,** në emër të deklaruesit dhe të bashkëshortit të krijuara nga puna e bashkëshortit G.K. në SHBA, në vlerën 3.474,72 USD. Zotërimi 50% me bashkëshortin.

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e saj. Nuk ka dyshime mbi këtë llogari.

- 8. Llogari rrjedhëse në USD te “Bank of America”, SHBA,** në emër të deklaruesit dhe bashkëshortit të krijuara nga puna e bashkëshortit në SHBA, në vlerën 6.902,01 USD. Zotërimi 50 % me bashkëshortin.

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për krijimin e saj. Nuk ka pasur dyshime për këtë llogari.

- 9. Cash, të krijuara nga puna e bashkëshortit në Amerikë, në vlerën 10.000 USD, sjellë në Shqipëri** ndërmjet shërbimit: 1. MoneyGram. 2. Nëpërmjet shërbimit bankar në “Intesa Sanpaolo Bank”. 3. Cash, fizikisht nga bashkëshorti ose nga subjekti i rivlerësimit. Zotërimi 50% me bashkëshortin.

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për këtë likuiditet. Nuk ka pasur dyshime lidhur me këtë likuiditet.

### **Lidhur me detyrimet financiare**

Në deklaratën “Vetting” është deklaruar kredi për blerje dhe mobilim shtëpie, shlyerje të kredisë së mëparshme. Kreditori “Alpha Bank” Tiranë. Bashkëkredimarrës - bashkëshorti G.K. Vlera e detyrimit të paslyer është 16.973.70 euro.

Nga hetimi administrativ u verifikuan deklaratimet e subjektit dhe u vërtetua se ato përputhen me dokumentet e administruara. Nuk ka dyshime lidhur me këtë kredi.

Gjate hetimit administrativ, në deklaratimet periodike të subjektit, ka rezultuar se këto deklarime kanë qenë përgjithësisht në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

Deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e paraqitur prej tij dhe dokumentet e ardhura nga institucionet kompetente.

Trupi gjykues, pasi ka kryer një proces verifikimi lidhur me këto deklarime, ka konstatuar se:

#### **1. Në deklarinimin për vitin 2003 dhe në deklarinimin për vitin 2005, nuk është deklaruar pjesa takuese (1/4) e bashkëshortit të subjektit, në një banesë të blerë nga ish-Ndërmarrja Komunale Banesa.**

Nga hetimi administrativ rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.06.2005, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. G.K., së bashku me z. H.K., znj. Y. K., z. D.K., kanë shitur apartamentin me sipërfaqe prej 75 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”.

Këtë apartament familja K. e ka përfutuar nëpërmjet kontratës së shitblerjes me Ndërmarrjen Komunale Banesa, Nr.2, Tiranë, në vitin 1993.

Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 nuk përmendet bashkëpronësia e bashkëshortit të z. G.K. mbi apartamentin me sipërfaqe prej 75 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”. Gjithashtu, nuk deklarohet shitja e këtij apartamenti në deklaratën e pasurisë së vitit 2005 nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në këtë mënyrë nuk është përmbushur një detyrim ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit (*për personin e lidhur*) dhe për këtë arsye ka rezultuar një pasaktësi në deklarinimin për vitin 2003 dhe në deklarinimin për vitin 2005.

Në lidhje me këtë pasaktësi i është kërkuar informacion shtesë subjektit të rivlerësimit, znj. Brudilda Kadi, e cila sqaron se: “Pronësia mbi këtë apartament nuk është deklaruar, pasi ajo i ka kaluar de fakto vëllait të bashkëshortit. Për këtë vëllai i ka dhënë bashkëshortit të saj shumën 50.000 leke, në momentin që bashkëshorti ka blerë një shtëpi tjetër 55 m<sup>2</sup> në vitin 1997,

*shitur në vitin 2011*”. Me barrën e provës ka paraqitur në deklarate noteriale me nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol., datë 15.07.2018, të familjarëve të bashkëshortit, të cilët vërtetojnë që në vitin 2003 nuk ka qenë bashkepronar de facto, por vetëm *de jure*. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, është vërtetuar shitja e kësaj pasurie me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.06.2005, te G., N., B. dhe A.P. kundrejt vlerës 3.500.000 lekë.

Në përfundim, duke marrë në konsideratë vlerën e vogël të pjesës takuese të bashkëshortit të subjektit në pasurinë apartament banimi, me sip. 75 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”, Komisioni çmon se pasaktësia objekt shqyrtimi, nuk ka sjellë asnjë pasojë në gjendjen financiare të subjektit. Mosdeklarimi i shitjes së pjesës takuese të bashkëshortit dhe përfitimit prej tij të shumës prej 875.000 lekësh, në deklarin për vitin 2005, në fakt nuk është në favor të subjektit, pasi nëse do të ishte deklaruar, kjo shumë do të përbënte një pjesë të të ardhurave të ligjshme të saj. Si rrjedhim pasaktësia formale e konstatuar nuk përbën provë për veprime me qëllim përfitimi apo fshehje pasurie nga ana e subjektit

## **2. Në deklarin për vitin 2004, rezulton të mos jetë deklaruar një autoveturë tip “Mercedes-Benz” 190D, shitja e së cilës është deklaruar në deklarin periodik për vitin 2017.**

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se për vitin 2007 subjekti i rivlerësimit deklaroi shitjen e makinës tip “Mercedes-Benz” 190 D nga bashkëshorti i saj në vlerën 330.000 lekë. Ky automjet vërtetohet të jetë blerë në vitin 2004, por nuk është deklaruar në deklarin periodik përkatës nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Në ushtrim të përmbushjes së të drejtës së barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime të hollësishme lidhur me këtë automjet<sup>7</sup>. Nga analiza e gjithë dokumentacionit dhe sqarimeve të dhëna prej saj, rezultoi se subjekti paraqiti si provë shkresore procesverbalin e datës 28 tetor 2014, mbajtur nga z. A.B., inspektor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, me te cilën dokumentoi se është bërë deklarimi i autoveturës si më sipër.

Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie (*për të cilën ka deklaruar shitjen në deklarin për vitin 2007*). Mospërmendja e këtij mjeti në deklaratën periodike për vitin 2004 nuk ka qenë me qëllim fshehjen e kësaj pasurie.

## **3. Në deklarin për vitin 2004 nuk është shënuar pjesa takuese e bashkëshortit të subjektit, G.K, në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.**

Sipas informacionit publik të siguruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka qenë aksioner me 30 % të aksioneve dhe përfaqësues ligjor i “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 14.01.2003 - 14.05.2004. Gjithashtu, rezulton se aksionet

---

<sup>7</sup> Shih pyetësorin dhe përgjigjet e datës 30.04.2018 si dhe shkresën nr. \*\*\* , datë 19.07.2018.

e z. K. janë transferuar më datë 06.05.2004 te ortakët e tjerë të shoqërisë bazuar në kontratën e blerjes së kuotave.

Duke qenë se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar 30 % të aksioneve në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., është konstatuar një pasaktësi në deklarinimin për vitin 2003. Ndërkohë, nga analiza financiare ka rezultuar se pjesëmarrja në këto aksione, për një periudhë prej rreth një viti, nuk ka sjell te ardhura për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit.

Gjatë komunikimit me subjektin, me pyetësin e datës 30.04.2018, lidhur me këtë pasaktësi, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Nuk e ka deklaruar në deklaratën për vitin 2003, pasi në datën 25.12.2003, me vendim të asamblesë së ortakëve, të gjithë aksionerët kanë vendosur të prishin shoqërinë dhe për këtë kanë paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çregjistrimin e saj. Kjo provohet me vendimin e sipërcituar, vërtetim nënshkrimi para noterit, datë 29.12.2003, dhe kërkesa e paraqitur në gjykatë, e sigluar, më datë 13.01.2004. Në këto kushte, kur është plotësuar deklarata për vitin 2003, duke pasur këtë informacion dhe duke e konsideruar që kjo shoqëri është prishur me vendim të asamblesë para datës 31.12.2003, nuk është bërë deklarimi. Ndërkohë, nga sa ju shpjegohet nga bashkëshorti, me aq sa ai kujton pasi ka kaluar një kohë e gjatë, ortakët janë tërhequr nga ky vendim dhe kjo kërkesë, dhe kanë vendosur të vazhdojnë, por bashkëshorti ka vendosur të tërhiqet. Për këtë arsye është bërë edhe shitja e kuotave, më datë 06.05.2004, dhe largimi i tij nga kjo shoqëri. Duke qenë se bashkëshorti nuk kishte më aksione në këtë shoqëri nga kjo datë, nuk është bërë deklarimi i tyre edhe në deklaratën e pasurisë pasardhëse të vitit 2004. Shpjegoj se, nga data e krijimit, deri në largimin e bashkëshortit nga kjo shoqëri, ajo nuk krijoi asnjë të ardhur.”*

Gjatë hetimit administrativ u vërtetua që më datë 25.12.2003, me vendim asambleje, aksionerët kanë vendosur të prishin shoqërinë. Ndërkohë, më datë 06.05.2004, bashkëshorti i subjektit ka shitur kuotat dhe është larguar nga shoqëria. Në këto kushte, dhe duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të kuotave të bashkëshortit në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe faktin që nuk janë përfituar të ardhura nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk ka sjellë pasoja në vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes financiare të subjektit, si dhe nuk ka pasur për qëllim fshehje pasurie nga ana e saj. Shoqëria “\*\*\*\*”, që nga momenti kur është regjistruar më datë 14.11.2003 deri më datë 06.05.2004 kur bashkëshorti i subjektit ka shitur aksionet, nuk ka realizuar të ardhura. Si rezultat nuk kemi pasoja financiare nga mosdeklarimi i pronësisë së 30 % të aksioneve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit**

**Sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/ 2016:**

- a. Deklarimi në deklaratën “Vetting” është i saktë dhe në përputhje me ligjin. Pasaktësitë e konstatuara në deklarimet ndër vite nuk kanë sjellë pasoja të tilla që ato të konsiderohen të pamjaftueshme në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016;**
- b. Nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë.**

- c. Nuk është kryer fshehje pasurie;
- d. Nuk ka deklarime të rreme;
- e. Subjekti nuk ndodhet në situatën e konfliktit të interesit.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

### MBLEDHJA E INFORMACIONEVE DHE PROVAVE MBI PASTËRTINË E FIGURËS SË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/206. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.10.2017 dhe deklasifikuar me **vendim të KDZH-së nr. \*\*\* prot.**, datë 08.01.2018, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, **ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi.**

#### Hetimi i kryer nga KPK

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### MBLEDHJA E INFORMACIONEVE DHE PROVAVE MBI VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE TË SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, ZNJ. BRUNILDA KADI

**Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, **dhe ka dërguar një raport<sup>8</sup>** të hollësishëm dhe të arsyetuar.

**Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:**

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

#### Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së

---

<sup>8</sup> Me shkresën nr. \*\*\*, datë 27.12.2017, dërgohet raporti i KLD-së.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtaren Brunilda Kadi janë paraqitur gjithsej 7 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 ankesë në vitin 2013, 5 ankesa në vitin 2014, 1 ankesë për vitin 2015 dhe asnjë ankesë në vitin 2016).

2 ankesa (një e vitit 2013 dhe një e vitit 2014) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. Edhe 3 ankesa të vitit 2014 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, por me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura.

2 ankesa të tjera janë verifikuar dhe rezultatet e tyre janë si vijon:

- i. 1 ankesë e vitit 2014 është verifikuar në lidhje me vonesën në dorëzimin e dosjes në sekretari dhe është konstatuar vonesë prej 9 ditësh, që i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik;
- ii. 1 ankesë e vitit 2015 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe në raportin e verifikimit të Inspektoratit është konkluduar se *“duke u bazuar në shkaqet e shtyrjes së seancave, nuk konstatohet ndonjë mangësi në organizimin dhe planifikimin e punës nga gjyqtarja Brunilda Kadi. Gjykimi ka kaluar afatin standard për shkaqe që nuk vareshin nga vullneti i saj. Kalimi i afatit standard të gjykimit t’i llogaritet gjyqtares për efekt të sistemit të vlerësimit profesional”*.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Brunilda Kadi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit u bazua në gjetjet e këtij raporti dhe, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku u konstatua:

### **1. Aftësitë profesionale**

#### **a) Njohuritë ligjore**

Subjekti i rivlerësimit Brunilda Kadi ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile në funksion të zgjidhjes së saktë të çështjes. I kushton rëndësinë e duhur identifikimit të kërimit të palëve, dëgjon kërkimet procedurale të tyre, shprehet në çdo rast me urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara, tregon vëmendje për formën e provave të kërkuara nga palët dhe përdor instrumentet ligjore për kërkimin e provave apo të të dhënave, kur palët nuk kanë mundësi të kryejnë veprimet e duhura.

Tri dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile materiale dhe procedurale, ku bien në sy e drejta e detyrimeve dhe ekzekutimi i detyrueshëm i titujve. Gjithashtu, ajo ka njohuri edhe për masat e sigurimit, mosmarrëveshjet administrative dhe të drejtat e pronësisë. Vlen të evidentohet se dokumenti nr. 2 i paraqitur prej saj është jashtë periudhës së rivlerësimit.

#### **b) Arsyetimi ligjor**



Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Gjithashtu, te të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar saktë shkakun dhe bazën ligjore.

## **2. Aftësitë organizative**

### **a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë**

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën civile. Ajo ka deklaruar se në periudhën 2013 - 2016, i janë caktuar për gjykim 1710 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 1396 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 81.6 %.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, gjyqtarja Brunilda Kadi ka përfunduar gjithsej 1028 çështje gjyqësore, nga të cilat 590 çështje civile të përgjithshme, 355 kërkesa civile, 1 çështje penale, 3 çështje tregtare dhe 79 kërkesa penale.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Brunilda Kadi ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë (masë sigurimi) deri në 9 muaj e 3 ditë. Çështja, që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, 9 muaj e 3 ditë ka qenë çështje themeli, e shqyrtuar në një seancë përgatitore dhe 8 seanca gjyqësore dhe në përfundim është disponuar me vendim pranimit të padisë, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Në tri dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 3 muaj e 17 ditë, 6 muaj e 14 ditë dhe 2 muaj e 3 ditë.

*Në 3 dosje të vëzhguara është konstatuar se është tejkuluar afati standard i gjykimit, megjithatë shkak për tejkalimin e afateve nuk ka qenë në asnjë rast sjellja e gjyqtares. Konkretisht, shkak për tejkalimin e afateve standarde është bërë mungesa e sistemit të adresave, leja vjetore e gjyqtarëve dhe sjellja e palëve ndërgjyqëse.*

*Për sa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit nuk mund të nxirren përfundime, pasi nuk ka të dhëna se kur janë regjistruar apo shortuar çështjet.*

Është e vërtetë që gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj saj është paraqitur një ankesë për kohëzgjatjen e gjykimit civil, i cili kishte tejkuluar afatin standard të gjykimit. Megjithatë, nga verifikimi i kësaj anekese nuk janë konstatuar mangësi në organizimin dhe planifikimin e punës nga gjyqtarja Brunilda Kadi. Gjykimi ka kaluar afatin standard për shkaqe që nuk vareshin nga vullneti i saj.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Brunilda Kadi i kushton rëndësi të veçantë arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Në të 5 rastet, dosja gjyqësore së bashku me vendimin përfundimtar është dorëzuar prej saj një ditë pas shpalljes së vendimit, që tregon se në çdo rast, vendimi i shpallur prej saj në seancë gjyqësore ka qenë i arsyetuar. Në këtë pikë, duhet evidentuar se ndaj saj është paraqitur një ankesë në periudhën e rivlerësimit, që i është regjistruar për vlerësim profesional për shkak të vonesës – gjithsej 9 ditë, në depozitim të dosjes gjyqësore në sekretari. Duke analizuar në tërësi të dhënat e saj në raport me këtë ankesë, konstatohet se ngarkesa e saj e lartë sasiore justifikon këto ditë vonese.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Brunilda Kadi ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal, ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesa vendimet gjyqësore.

#### b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, duke qenë efektive në përfundimin në kohë të tyre. Një tipar i mirë i punës së saj është vënia në lëvizje e çështjes menjëherë përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në 4 çështje civile të vëzhguara, ajo ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore, duke saktësuar kërkimet e palëve dhe duke verifikuar nëse ekzistonte mundësia e palëve për ta zgjidhur çështjen me pajtim. Veprimet përgatitore të kryera janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale. Në këto 4 çështje civile, gjykimet kanë përfunduar me 4 - 10 seanca. Ndërsa çështja tjetër e vëzhguar lidhet me vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, që është përfunduar me një seancë.

#### c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile. Në të 5 dosjet e vëzhguara gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore ose gjyqësore. Në fashikull përfshihen aktet e njoftimit të palëve, të firmosura nga subjekti i rivlerësimit dhe dëftesat e komunikimit të vendimit për palët në mungesë. Duhet evidentuar se në asnjë rast seancat nuk kanë dështuar për shkak të njoftimeve të parregullta të palëve.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### a) Etika në punë

Gjyqtarja Brunilda Kadi ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 08.07.1999 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Pas studimeve, në datën 21.10.2003, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe në datën 14.11.2011 është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prej datës 14.12.2015 e në vazhdim, është anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Brunilda Kadi. Dy ankesa që i janë regjistruar për vlerësim profesional lidhen me aftësitë e saj organizative dhe nuk i përkasin etikës në punë. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me ndikimin e saj nga presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore (një jashtë periudhës së rivlerësimit) të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, nuk ka respektuar rregullat procedurale.

#### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Brunilda Kadi komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore (një jashtë periudhës së rivlerësimit) dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore (një jashtë periudhës së rivlerësimit) dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Brunilda Kadi për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të gjitha rastet (përveç dokumentit 3, ku ka qenë kryesuese e trupit gjykues), subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale. Në 5 dosjet është konstatuar se bashkëveprimi me administratën gjyqësore ka qenë në nivelin e duhur, pasi nuk është konstatuar vonesë në fillimin e seancave gjyqësore dhe depozitimin e dosjes me vendimin e arsyetuar.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Pas disa viteve nga diplomimi "Jurist" në vitin 1999, ajo ka marrë titullin "Magjistrat gjyqtar" nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2003. Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë

që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 14 trajnime në Shkollën e Magjistraturës. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në përbërje të dhomës civile.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, ka deklaruar se ka marrë pjesë në 4 aktivitete jashtë programit të kësaj shkolle, të cilat janë brenda periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, ndër të cilat ka marrë pjesë si eksperte e nivelit të lartë për hartimin e ligjeve mbi gjyqësorin në procesin e reformës në drejtësi në vitin 2016, si dhe si përfaqësuese e KLD-së në aktivitete jashtë vendit, konkretisht në Malin e Zi dhe Spanjë, si dhe vizitë studimore në Oslo, Norvegji.

**Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, bazuar në ankesat e subjekteve denoncues si më poshtë:**

1. në denoncimin e z. H.M.;
2. në denoncimin e z. Sh.S.;
3. në denoncimin e z. A.L.;
4. në denoncimin e znj. L.D.;
5. në denoncimin e z. A.L.;
6. në denoncimin e z. Sh.H.;
7. në denoncimin e z. E.I.M.

**Ankesa 1.**

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 27.04.2018, z. H.M. denoncon subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, për zvarritje në proces, pasi e mbajti çështjen për 2 vite e gjysmë në seanca gjyqësore dhe në fund u shpreh për moskompetencë territoriale.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.11.2014, trupi gjykues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i përbërë nga 3 gjyqtarë, midis të cilëve znj. Brunilda Kadi, vendos shpalljen e moskompetencës tokësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes civile nr. \*\*\* akti, që u përket paditësve F.M., M.M., Xh.M., S.M., me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ të vendimit nr. \*\*\*, datë 19.09.2012, të AKKP-së Tiranë dhe njohjen e së drejtës së kthimit dhe kompensimit të pronës të sipërfaqes 86055 m<sup>2</sup> tokë bujqësore, sip. 4000 m<sup>2</sup> dhe sip. 6360 m<sup>2</sup> kullotë të ndodhura në fshatin Gjericaj të komunës Ishëm, qarku Durrës.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit iu drejtua me shkresën nr. \*\*\*, datë 29.06.2018, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku i kërkonte dosjen e plotë të vendimit.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 03.07.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë na informon ndër të tjera se kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Lartë Tiranë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 08.01.2015, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 20.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”, si dhe dosja është dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

***Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga z. H.M. nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.***

**Ankesa 2.**

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2017, z. Sh.S. denoncon subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, për aftësinë profesionale, pasi ka gjykuar në mënyrë të njëanshme çështjen me paditës z. Sh.S. kundër Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Nga vendimi i Gjykatës së Rrethit nr. \*\*\*, datë 09.10.2017, rezulton se z. Sh.S. ka paditur Akademinë e Shkencave të Shqipërisë me objekt padie si më poshtë:

1. Detyrimin e palës së paditur të njohë dhe të promovojë 2 punimet shkencore “Teoria kuantitative (korpuskulare) e impulsit nervor” si dhe “Realiteti i relativitetit dhe bashkëveprimi i pafund”. Kjo të konkretizohet me botimin e tyre në periodikun e Akademisë, si dhe organizimin e konferencave shkencore.
2. Në vazhden e promovimit, studimet të dërgohen në Akademinë Mbretërore të Shkencave Suedi për marrjen e një çmimi “Nobel”. Natyrisht ky do të jetë një vlerësimi i ri për shkencën shqiptare.
3. Dëmshpërblim ekonomik në shumën 700.000 lekë për shpenzimet dhe dëmin moral, t’i kërkojë të falur në mënyrë publike për persekcionin e kohës së diktaturës dhe për nëpërkëmbjen pas diktaturës që i është bërë ndaj punës dhe paditësit për 33 vite.

Me vendimin e mësipërm, gjyqtarja Kadi vendosi rrëzimin e padisë.

***Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga z. Sh.S., nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.***

### **Ankesa 3.**

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2017, z. A.L. denoncon subjektin e rivlerësimit. Denoncimit të tij z. L. i ka bashkëlidhur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 24.12.2015, “Për kthimin e kërkesë padisë”.

Sipas vendimit të sipërcituar, gjyqtarja Brunilda Kadi vendosi kthimin e kërkesëpadisë paditësve M.L., L.D. (L.), Q.L., V.L., L.L., H.L., A.L. kundër të paditurit shoqëria “\*\*\*\*”, pasi nga pala paditëse nuk janë plotësuar kërkesat ligjore për të cilat i është lënë kohë disa herë dhe paditësi A.L., përfaqësues i të gjithë paditësve, deklaroi se nuk kanë mundur të paguajnë taksën për pjesën e kërimit të padisë sipas vlerës që ka dalë nga akti i ekspertimit, pasi është shumë e madhe dhe ata janë në vështirësi financiare. Në përgjigje të pyetjes së gjykatës për vazhdimin e gjykimit, sipas objektit të përcaktuar në fillim të gjykimit, paditësi A.L., në emër dhe të paditësve të tjerë, deklaroi se nuk mund të vazhdojnë gjykimin për atë kërkim, nuk ka mundësi për të paguar taksën dhe se kërkon drejtësi.

***Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga A.L., nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.***

### **Ankesa 4.**

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 12.06.2018, znj. L.D. denoncon subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi për vendim të padrejtë.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.09.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses L.D., me objekt “Goditjen për falsitet të shkresës njoftim vendimi nr. \*\*\*, datë 21.01.2014, për caktimin e ekspertit dhe njoftimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 03.02.2014, për caktimin e çmimit të sendit” .

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 05.11.2015, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit civil nr. \*\*\*, datë 24.09.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

***Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga znj. L.D., nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncueses.***

### **Ankesa 5.**

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 18.05.2018, z. L.B. denoncon subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, për vendimmarrje në shkelje të ligjit.

***Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga z. L.B., nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.***

### **Ankesa 6**

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 18.07.2018, z. Sh.H. denoncon subjektin e rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, për paaftësi profesionale dhe nuk zgjidhi konfliktin për të cilin kishin shkuar në gjyq.

***Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga z. Sh.H., nuk ka indice për të provuar pretendimin e denoncuesit.***

### **Ankesa 7**

Me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit paraqitet ankesa e z. E.I.M., i cili shkruan me cilësinë e administratorit të “\*\*\*\*” s.l., me seli në Spanjë, Madrid. Në ankesën e tij, z. M. shprehet se në datën 8 nëntor 2017 kishte marrë një zarf nga Shqipëria që përmbante disa dokumente të cilat nuk ishin në gjuhën spanjolle. Në shkresën e tij ai shprehet se, sipas juristëve të tij, ndoshta është shkelur Konventa e Hagës e 15 nëntorit 1965 “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare”.

### **Veprimet hetimore të kryera nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit filloi veprimet hetimore duke siguruar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë të gjithë praktikën e plotë mbi ankesën e paraqitur nga z. E.I.M.

Nga kjo praktikë rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është regjistruar çështja civile me nr. regjistri themeltar \*\*\*, datë 23.05.2017, që u përket palëve: Paditës: B. K. Të paditur: 1. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me adresë Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë, Rr. “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, shk. \*\*\*, kati \*\*\*, hyrja \*\*\*, Tiranë. 2. Shoqëria “\*\*\*\*” s.l., me objekt: Konstatim pavarshmërie të pikës 3 dhe 4 të vendimit të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. të datës 07.04.2017.

Me shortin e datës 29.05.2017, kjo çështje ka kaluar për gjykim pranë subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi. Janë zhvilluar 12 seanca gjyqësore, 10 përgatitore dhe 2 gjyqësore.

Nga aktet e dosjes rezulton se pala paditëse kishte bërë gjithë përpjekjet për të marrë nga Spanja ekstraktin e shoqërisë “\*\*\*\*” s.l, të cilin pasi e marrin e përkethejnë dhe gjejnë një adresë tjetër të shoqërisë, - e cila është: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, *Madrid, Spain*, - dhe kërkojnë në seancën e datës 10.10.2017 që njoftimi të bëhet në këtë adresë. Gjykata e pranon këtë kërkesë, duke dërguar fletëthirrjen e datës 14.10.2017 për seancën e datës 14.11.2017 për të paditurin shoqëria “\*\*\*\*” s.l, në adresën: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, *Madrid, Spain*.

Bazuar në shkresën nr. \*\*\*, datë 31.05.2018, të kryetares së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. E.H., drejtuar Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë rezulton se në lidhje me komunikimin e akteve në një proces civil shtetasve të huaj, rregullimi procedural civil konkretizohet në nenin 135 të K.Pr.C.

Nga ana e Komsionit, me qëllim kryerjen e një hetimi të thelluar dhe të gjithanshëm, i është dërguar shkresë Ministrisë së Drejtësisë për të informuar mbi procedurën e njoftimit të një pale ndërgjyqëse në një proces gjyqësor shqiptar, kur pala ndërgjyqëse ndodhet me banim jashtë territorit shqiptar.

Me shkresën nr. \*\*\* prot./DS, datë 03.07.2018, Ministria e Drejtësisë informon se procedura që duhet të ndjekë gjykata për njoftimin e një pale ndërgjyqëse me banim jashtë territorit shqiptar parashikohet në nenin 219 të Kodit të Procedurës Civile, në Konventën e Hagës “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve Gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare” për shtetet palë, në Marrëveshjen Europiane për Transmetimin e Kërkesave të Ndhmës Gjyqësore etj.

**Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, duke nisur fletëthirrjen drejtpërdrejt në adresën e shoqërisë “\*\*\*\*” s.. në adresën: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, *Madrid, Spain*, - ka shkelur Konventën "Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare" të Konferencës së Hagës, bërë më 15 nëntor 1965, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 9554, datë 8.6.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ‘Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare’”, si dhe nenet 135 dhe 219 të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.**

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit dha qëndrimin e saj, i cili u vlerësua nga trupa gjyqësore por nuk u mor në konsideratë.

### ***Arsyetimi ligjor dhe rivlerësimi profesional***

Sipas dispozitave të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 84/2016: “Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

Pika 2 e nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 përcakton që: “Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave,

për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën”.

Pika 4 e nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 përcakton që: Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

#### **Trupi gjykues, - duke pasur në konsideratë:**

- Nenin E, pika 1, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: “*Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit*”;
- Nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: “*Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues*”;
- Vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “*...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL -AD (2016)036 të Komisionit të Venecias*);
- Nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, “*subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë...*”.

**- arsyeton se për mangësitë e konstatuara në dosjen civile nr. \*\*\* akti, të referuar sa më sipër, nuk rezultuan të dhëna/prova, që të provonin se ato ishin të paramenduara, si dhe nuk janë të mjaftueshme:**

- Për t’i çmuar ato si sjellje e përgjithshme dhe të vazhdueshme e subjektit (duke marrë në konsideratë trajtimin që ai ka bërë në dosjet e tjera);

-Për ta vlerësuar atë me mangësi profesionale; si dhe

- Nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë /praktikë pune të papajtueshëm me pozicionin e tij.

Sa më sipër, si dhe për shkak të kufizimit për të mos zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit, trupi gjykues çmon vetëm mangësitë e gjetura në dosje, duke vlerësuar se këto mangësi mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor të tij, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Kjo pasi Komisioni konstatoi mosrespektimin e një procedure të parashikuar nga dispozitat ligjore, por subjekti i rivlerësimit pohoi se veprimtaria e saj profesionale, në lidhje me këtë dosje, ka qenë në përputhje të plotë me udhëzimet dhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës, ku ajo bënte pjesë, si dhe që kjo “rrugë” e zgjedhur ishte më efikase dhe më e shpejtë.



Pra, duke pasur parasysh që verifikimet e rrethanave të mësipërme, që janë gjetur në një rast të vetëm, konsiderohet më e përshtatshme që këtë vlerësim konkret, mbi shkeljet e mundshme dhe mbi pasojat, ta bëjë një komisioni *ad hoc* për procedim disiplinor.

Për rrjedhojë të sa më sipër, sa i përket dosjes nr. \*\*\* akti, bazuar në nenin 40, pika 1, germa “c”, në nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, çmon ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim për shkelje disiplinore.

Gjithashtu, trupit gjykues gjatë vlerësimit të aftësive etiko-profesionale ndaj subjektit të rivlerësimit:

✓ nuk i rezultuan elemente që ta identifikonin atë me të meta apo probleme në gjykimin e rasteve të tjera individuale, të tilla si mosrespektim i afateve ligjore, referenca të gabuara ligjore, dosje të paplota, sipas neneve 72 - 74 të ligjit nr. 76/2016;

✓ nuk i rezultuan të dhëna apo gjetje negative nga regjistri i ankesave dhe procedimeve disiplinore;

✓ nuk rezultuan të dhëna negative lidhur me trajtimin e çështjeve sipas neneve 75, 76 të ligjit nr. 96/2016.

Në këto kushte, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara vetëm në një rast, për subjektin e rivlerësimit, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në vlerësimin e tij “me mangësi” ose si “i papërshtatshëm”. Sa më sipër, në konkluzionin përfundimtar trupi gjykues nuk mund të arrijë në një vlerësim tjetër për subjektin e rivlerësimit, përveçse: “I aftë”.

### **Konkluzioni përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, plotëson kushtet e mëposhtme:

- Përtej pasaktësive dhe mangësive në deklarinimin e disa të dhënave pasurore të ulëta, arrin në një nivel të mjaftueshëm dhe të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- Arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- Arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, 4 të

ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Kadi, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Transferimin e çështjes nr. \*\*\* akti, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të kryhet ankim pranë Kolegjit të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 01.08.2018

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim Hamitaj**  
**Kryesues**

**Firdes Shuli**  
**Anëtar**

**Roland Ilia**  
**Relator**

**Sekretare gjyqësore**  
**Olsida Goxhaj**